


**ENCIKLOPEDI ARKEOLOGJIKE E PERIUdhËS
SË ANTIKITETIT PËR RAJONIN E PEJËS**

Prof. dr. Naser Ferri, *Peja gjatë antikitetit - Peja during antiquity*,
Instituti Albanologjik, Prishtinë 2019, 395 f.



Kohë më parë Instituti Albanologjik i Prishtinës botoi monografinë “Peja gjatë antikitetit - Peja during antiquity” të autorit prof. dr. Naser Ferri.

Prof. dr. Naser Ferri është një ndër arkeologët e parë në Kosovë. Fokus të punës së vet shkencore e ka arkeologjinë, historinë antike, epigrafinë e tekstet latine, mitologjinë, etnoarkeologjinë dhe historinë e artit. Prof. Ferri ka përfunduar studimet universitare në Degën e Arkeologjisë të Fakultetit Filozofik në Universitetin e Zagrebit në vitin 1978 dhe ato pasuniversitare në vitin 1987. Në qershor të vitit 1979 ka filluar punën në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në Degën e Historisë, Sektori i Arkeologjisë, ndërsa në vitin 1997 ka mbrojtur tezën e doktoratës.

Që nga viti 1998 ka qenë i angazhuar në Universitetin e Prishtinës në cilësinë e ligjëruesit, kurse nga viti 2004 si profesor i rregullt i zgjedhur në Fakultetin Filozofik e më vonë edhe në Fakultetin e Filologjisë dhe atë të Edukimit në Prishtinë, Gjakovë e Gjilan, ku ka ligjëruar lëndët: Epigrafi e numizmatikë, Gjuhë latine, Histori e Etnologjisë, Mitologji e përgjithshme, Mitologji kombëtare shqiptare, Histori e artit, Histori e kulturës shqiptare.

Aktualisht është i angazhuar në Studimet e doktoratës në Universitetin e Zarës në Kroaci.

Vlerë të madhe të arkeologjisë së trojeve shqiptare, Prof. dr. Ferri i jep me pesë veprat e tij monografike: “Statusi shoqëror-ekonomik i të liruave në provincën romake Moesia Superior” (1996), “Monumentet e ushtrisë romake në Mezi të Epërme” (2001), “Mythologia Viva – Mitologjia e gjallë” (2012), “Živa Mitologjia-Living Mythology”, Zagreb (2015) dhe “Peja gjatë antikitetit - Peja during

Antiquity” (2019, që edhe është temë trajtimi e këtij recensionit) si dhe me një numër të konsiderueshëm studime të botuara nëpër revista prestigjioze shkencore me recensione ndërkombëtare.

Monografia më e re e Prof. dr. Naser Ferrit “Peja gjatë antikitetit - Peja during Antiquity” doli nga shtypi në vitin 2019 dhe është botim i Institutit Albanologjik në Prishtinë. Është kjo vepra e parë shkencore e kompletuar nga e cila mund të kuptosh të gjitha pasuritë arkeologjike të rajonit të gjerë të Pejës nga periudha e parahistorisë e posaçërisht gjatë antikitetit, kur ky rajon përbënte një tërësi. Duke marrë parasysh sasinë e informatave, fotomaterialit, hartave e materialit përcjellës ky botim është voluminoz dhe ka rreth 400 faqe. Përveç pjesëve hyrëse dhe mbyllëse, pjesa kryesore është e ndarë në katër kapituj në të cilët trajtohen historia dhe arkeologjia e rajonit të Pejës nga periudhat më të hershme, pastaj mitologjia dhe besimet, gjetjet e monumenteve epigrafike si dhe gjetjet numizmatike.

Prof. dr. Ferri e fillon librin me paraqitjen e një historiku të kërkimeve dhe të hulumtimeve arkeologjike e historike të periudhës së antikitetit të këtij rajoni. Është shumë me rëndësi kjo pasqyrë përmbledhëse për çfarëdo studiuesi të këtij rajoni, sepse në të shtjellohen burimet e shkruara duke filluar me udhëpërshkruesit e historianët nga Ptolemeu deri tek ata të shekullit XX. Prezantimi i historikut të gjurmëve dhe përnjohjeve në

teren nga ato të para luftës deri më sot përmbillet me Listën e lokaliteteve arkeologjike të vitit 2018 të Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit të Kosovës. Një pjesë shumë me vlerë paraqet studimi mbi emrin e lokalitetit antik të Pejës në të cilin autori, përmes burimeve të shkruara, gjurmëve arkeologjike dhe në bazë të teksteve të mbishkrimeve në monumenteve epigrafike ofron një analizë për vendbanimin e Pejës, që në fakt është edhe studim i bërë për herë të parë i kësaj natyre.

Është për keqardhje që emri i këtij vendbanimi nuk është ruajtur, ndërsa lidhur me mundësinë që kemi të bëjmë me një vendbanim në rang të municipiumit, autori i këtij studimi Prof. Ferri i zë në gojë edhe disa monumente epigrafike në tekstet e të cilëve përmendën dekurionet, respektivisht anëtarët e Këshillit apo Senatit municipal të vendbanimit emri i të cilit nuk përmendet ose në një rast monumenti është i thyer dhe i mungon pikërisht pjesa në të cilën duhet të ishte i shënuar emri i municipiumit. Autori thekson se për shkak të mungesës së fakteve mbi emrin e këtij vendbanimi, në të kaluarën, ka pasur tentime që, në bazë të supozimeve të gabuara në literaturë, vendbanimi antik në Pejë të pagëzohet me emra të pavërtetuar me fakte ose edhe të interpretuar gabimisht.

Prof. Ferri po ashtu cek faktin që, sipas dokumentacionit nga gjurmët mbrojtëse arkeologjike të bëra gjatë viteve 1978-1979, me rastin e ndërimit të Fabrikës së Baterive Indu-

striale në Fushë të Pejës, ishte dëshmuar që vendbanimi kishte pësuar dy herë në zjarre të mëdha dhe se, sipas gjasave, zjarri i dytë gjatë shekullit IV të erës sonë kishte qenë katastrofik, meqë pas kësaj shtrese të djegur nuk janë dëshmuar gjurmët e rindërtimit apo të ndërtimeve të mëvonshme në këtë lokalitet.

Kapitulli, i parë i titulluar “Histori dhe Arkeologji - History and Archaeology”, paraqet historinë e shtetit dardan, e në këtë kontekst edhe të rajonit të Pejës, bazuar në burime të shkruara duke i ndërlidhur edhe me gjetjet arkeologjike. Autori paraqet fillimisht burimet e shkruara nga autorët antikë duke vazhduar me shtjellimin e pushtimit romak të Mbretërisë Dardane, duke vazhduar me paraqitjen e një momenti kyç historik në rajon, i cili është pushtimi i Mbretërisë Dardane dhe krijimi i provincës së Mezisë dhe ndarjes së saj, e më pas reagimet e dardanëve pas këtyre ndryshimeve. Ky kapitull shërben për të kuptuar qartazi historinë e rajonit të Pejës në kuadër të Mbretërisë Dardane dhe më vonë, gjatë pushtimit romak, e ku më pas do të jetë më e lehtë të pranohen të dhënat e tjera në kapitujt e radhës.

Në kapitullin e dytë “Mitologji dhe besime - Mythology and beliefs”, që është pjesë shumë e rëndësishme nga aspekti shkencor, autori paraqet qartë kultet dhe besimet vendëse dardane dhe ndikimet nga jashtë, respektivisht nga kulturat e qytetërimet e tjera. Këtu kuptojmë ndikimin e kulteve të hyjnive egjiptiane, greke e

romake dhe depërtimin e tyre në këtë rajon. Prof. dr. Ferri veçon në këtë kapitull hyjnitë e besimet të cilët kanë lënë gjurmë të prekshme në rajonin e Pejës, e më pas duke na prezantuar i trajton edhe perënditë specifike në Dardanië antike në bazë të teksteve të monumenteve epigrafike. Ky kapitull përfundon me paraqitjen e fillimeve të judeo-krishterimit e të krishterimit të hershëm dhe përhapjes së tij si dhe gjurmët e krishterimit në monumente epigrafike dhe anepigrafike, meqë në rajonin e Pejës janë dëshmuar edhe gjurmët e krishterimit të hershëm (simbolet e hershme karakteristike për këtë konfesion dhe mbetjet sporadike të objekteve arkitektonike paleokrishtere brenda qytetit dhe nëpër fshatra rreth Pejës së sotme). I gjithë ky proces dhe pasqyrim i besimit bëhet për herë të parë dhe na lë të kuptojmë për ndikimin e besimeve në trend botëror që kishin në rajon.

Kapitulli i tretë, me titullin “Epigrafi - Epigraphy”, po ashtu sjell për herë të parë një katalog të monumenteve epigrafike sepulkrale, votive e të monumenteve të këtilla në objekte publike të gjetura në rajonin e Pejës nga fundi i shekullit XIX, gjatë atij XX e deri në fillim të shekullit XXI. Përveç paraqitjes së tyre, është bërë analizimi dhe trajtimi shkencor, ku janë trajtuar këto monumentet deri tash të gjetura, bazuar në formën, mbishkrimet, paraqitjet ikonografike dhe tekstet e mbishkrimeve në gjuhë latine. Dokumentimi është një nga

proceset më të rëndësishme në shkencën e arkeologjisë.

Përmes kësaj pune, autori na sjell të kompletuara të gjitha monumentet e rajonit në fjalë, përfshirë edhe disa që sot nuk gjenden fizikisht, ose janë bartur gjatë kohës së ish-Jugosllavisë në Maqedoni e në Serbi. Me anë të kësaj vepre edhe ato monumente janë të evidentuara, të dokumentuara e do të qëndrojnë në memorien dhe do të shërbejnë për studiuesit e gjeneratave të ardhshme. Analiza e Prof. dr. Ferrit është e thellë, ku përveç paraqitjes fotografike, këto monumente epigrafike janë të përshkruara në detaje dhe të analizuara sipas normave e metodave bashkëkohore shkencore.

Kapitulli i katërt me titull “Numizmatikë - Numismatics” është po ashtu një prurje shumë e rëndësishme për shkencën e arkeologjisë dhe studiuesit e saj. Numizmatika si shkencë është shumë pak e shtjelluar nga arkeologët në Kosovë, e në anën tjetër është një prej veglave më të rëndësishme për datimin dhe njohjen e lokaliteteve arkeologjike. Duke marrë parasysh se rajoni i Pejës është mjaft i pasur me gjetje të monedhave antike, prof. dr. Ferri ka bërë një paraqitje të monedhave ilire nga shekujt II - I para erës sonë dhe romake nga shekulli I deri në shekullin IV të erës sonë dhe analizat në bazë të lokaliteteve se ku janë gjetur. Autori, përveç analizave të monedhave të gjetura, gjithashtu bën edhe një prezantim të hollësishtëm të historikut të gjetjeve dhe të lokaliteteve. Për më tepër në këtë kapitull kuptojmë edhe njohuri të për-

gjithshme për numizmatikën si shkencë. Për më tepër në këtë kapitull kuptojmë edhe njohuri të përgjithshme për numizmatikën si shkencë.

Në bazë të te dhënave nga monumentet epigrafike (veshmbathja, stolltë, onomastika), autori konkludon se pjesa dërrmuese e popullatës në rajonin e Pejës gjatë antikitetit kishte qenë indigjene me origjinë dardane, por konstaton edhe faktin se, pos popullatës vendëse, kishte pasur edhe ardhacakë romakë, pastaj ilirë nga Dalmacia e pjesët e tjera të Ilirikut dhe të Perandorisë Romake si dhe njerëz me origjinë orientale të cilët në këtë rajon kishin arritur bashkë me ushtri romake në cilësi dhe me detyra të ndryshme.

Duke marrë parasysh seriozitetin e kësaj vepre, asaj nuk i mungon as aparatúra përkatëse shkencore: rezyrmeja në gjuhën angleze (e përkthyer nga prof. Orest Ferri), treguesi i emrave e nocioneve, treguesi gjeografik si dhe shkurtesat e bibliografia e pasur me mbi 270 njësi bibliografike. Lista e bibliografisë në këtë botim është gjithashtu një vegël shumë e rëndësishme për studiuesit e rinj, sepse listohen burimet më të rëndësishme nga kjo shkencë dhe literatura shkencore duke filluar që nga shekujt e kaluar e deri te botimet më të reja të ditëve tona të publikuara në gjuhën angleze, italiane, kroate, gjermane, franceze, spanjolle, sllovene, maqedonase e në disa gjuhë të tjera e që lidhen me këtë periudhë. Gjithashtu, për t’u vlerësuar është numri i madh i fotografive, skicave, hartave dhe ta-

belave që kanë të bëjnë me thesarin e pasur arkeologjik të rajonit të Pejës, të cilat pasurojnë në masë të madhe këtë botim të veçantë.

Vlen të përmendet se profesori Ferrri është vetë edhe autor i zgjedhjes ideore shumë të qëlluar të ballinës së kësaj vepre.

Si përfundim, libri “Peja gjatë antikitetit - Peja during Antiquity” është vlerësuar në superlative nga dy recensentët kroatë: Akademik Nenad Cambj, arkeolog dhe profesor emeritus nga Spliti dhe nga Mr. Sc. Kristina Dzin, bashkëpunëtoreshë shkencore dhe mësimdhënëse universitare nga Zagrebi, po ashtu arkeologe.

Për me tepër ka fare pak e botime nga lëmi i arkeologjisë në Kosovë, duke bërë që “biblioteka” arkeologjike e Kosovës të jetë shumë e varfër, prandaj veprat si këto të Prof. Ferrit, e posaçërisht monografia “Peja gjatë antikitetit”, janë me shumë vlerë për studiuesit e tashëm dhe ata në ardhje të arkeologjisë së Kosovës dhe jashtë vendit si dhe për studentët e arkeologjisë, historisë, etnologjisë e të shkencave simotra.

Zana Hoxha, PhD candidate

